

## **SHEFKI JAUPI**



Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, KLSH. Lindur ne vitin 1963. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1987). 22 vite eksperience pune.8 vitet e fundit në KLSH. Auditues i Lartë nga viti 2011. Fusha e ekspertizes:

Auditimi i Projekteve me Financime te Huaja.

### **Auditimi i prokurimeve në entitetet publike<sup>iiiiii</sup>**

*nga Shefki Jaupi*

Disa nga elementet kryesore të këtij auditimi përfshijnë: buxhetimin (llogaritjen e çmimit), tenderimin, kontraktimin, zbatimin, marrjen në dorëzim, pagesat, regjistrimin dhe rakordimin kontabël etj. Ai gjithashtu përfshin funksione kyçe operacionale siç janë: procesi i zgjedhjes së kontraktorit, zbatimit të kontratës, ndryshimit të grafikut të operacioneve të marrjes së punës/ shërbimit/ mallrave në dorëzim etj. Ky auditim përfshin gjithashtu elementet e përputhshmërisë si: dokumentimi i fondit që nevojitet, zhvillimin e procesit në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi etj.

Për të planifikuar auditimin e një procesi tenderimi, audituesi duhet të mbajë parasysh fazat në të cilat ky operacion kalon, të cilat janë:

- Zgjedhja e tipit të procedurës në respekt të dispozitave ligjore të fushës që lidhen me kufijtë monetare, të cilat mund të jenë të hapura, të kufizuara/me negociim me ose pa njoftim paraprak etj.
- Publikimi i procedurave të tenderimit.
- Procedurat e tenderimit përfshijnë:
  - a) dokumentet e tenderit që janë dokumentet paraprake mbi hartimin e kritereve të vlerësimit të tenderit;
  - b) fillimin e procedurave të prokurimit;
  - c) hapjen dhe vlerësimin e tenderit/ ofertave dhe nxjerrjen e fituesit;
  - d) shpalljen e fituesit dhe hartimin e kushteve të kontratës;
  - e) nënshkrimi i kontratës dhe njoftimi i saj.
- Menaxhimi i kontratës përfshin:
  - a) procedurat e pagesës së kontraktorit bazuar në termat e kontratës dhe rregullave të menaxhimit financiar;
  - b) mënyrën e zgjidhjes se çdo problemi që ka lindur, ose amendim i kontratës;
  - c) mbikëqyrjen dhe kolaudimin e mallrave, shërbimeve ose punëve;
  - d) marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve ose punëve, dokumentimin, magazinimin, përfshirjen në evidencën kontabël.

Referuar katër fazave të mësipërme, si dhe elementeve të kontrollit të brendshëm etj, më në detaje dhe në mënyre të specifikuar, audituesi i prokurimeve publike duhet të kryej ato teste që ti japin përgjigje pyetjeve si më poshtë:

- Kërkesa për prokurim është e bazuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik i cili botohet në formë elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik?

- A është vlerësuar dhe miratuar nga nëpunësi autorizues në cilësinë e të deleguarit të titullarit kërkesa për prokurim?
- A është hartuar dhe miratuar urdhri për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike?
- A ka kryer komisioni i llogaritjes së fondit limit ?
  - i) analizën e tregut;
  - ii) vlerësimin e objektit të prokurimit duke propozuar procedurën më të përshtatshme për zhvillimin e prokurimit.
- A ka zbatuar dispozitat ligjore e rregullative në përlllogaritjen e vlerës limit?
- A ka hartuar dhe firmosur procesverbalin për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, i cili përfshin të gjithë analizën e kryer nga komisioni?
- A është hartuar dhe miratuar urdhri i prokurimi, i cili duhet të përmbajë: bazën ligjore, objektin e prokurimit, fondin e vënë dispozicion, llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj. Kush ngarkohet për zbatimin e tij dhe kur hyn në fuqi? Njësia e prokurimit a ka marrë në konsideratë fondin limit të përcaktuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim?
- A janë miratuar dokumentet e tenderi?
  - i) Është dokumentacioni teknik i mjaftueshëm dhe në përputhje me tipin e kontratës që kërkohet?
  - ii) A është hartuar dokumentacioni teknik nga staf kompetent sipas fushës dhe a ka akt zyrtar që e ngarkon këtë staf me hartimin e dokumentacionit teknik?
  - iii) A ka dhe a janë respektuar limitet kohore të njoftimit të tyre (dokumentacionit teknik)?

- iv) A janë specifikimet teknike të tilla që të lejojnë në mënyrë të barabartë të gjithë kandidatet e mundshëm potencialë të marrin pjese? A ka kritere të pa-justifikuara të vëna me qëllim pengimin e pjesëmarrjes së tyre në tender?
- v) A kanë kërkuar të interesuarit sqarime lidhur me specifikimet teknike dhe a u është kthyer përgjigje brenda afateve kohore?
- A është mbajtur procesverbal për hartimin e dokumenteve të tenderit?

**Ka dhe shumë pyetje specifike që bëhen për Kërkesat për kualifikim, Kriteret e vlerësimit, Specifikimet Teknike, Njoftimin për Tender, Njoftimin e Kontratës dhe Termat e Referencës.**

Prokurimi Publik është i rregulluar me ligj e sipas ligjit, kjo fushë është që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të përdorimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen. Megjithatë, në procesin e prokurimit publik, konstatohen parregullsi, gabime dhe shkelje të shumta të dispozitave ligjore e nënligjore. Kështu, gjatë auditimit nga KLSH të dosjeve të tenderave në entitetet publike është vërejtur se autoritetet kontraktuese nuk kanë bërë një specifikim të qartë të kriterëve të veçanta të kualifikimit (shtojca 7 e Dokumenteve të Tenderit) duke mos iu dhënë informacione të qarta e të sakta operatorëve ekonomik në mënyrë që ata të përgatisin dosjen e tenderit. Kjo gjë ka shkaktuar konfuzion të operatorët ekonomik në përgatitjen e dosjes së tenderit. Në dispozitat e fushës së prokurimeve është përcaktuar që autoriteti kontraktor përcakton dokumentet/dëshmitë që duhet të paraqesë ofertuesi për tu kualifikuar.

Autoritetet kontraktuese nuk argumentojnë vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, konform me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla,

njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

Në disa raste konstatohet se, autoritetet kontraktore përcaktojnë kushtet e tenderit, sipas kërkesave të fituesit, duke krijuar një mjedis ku bizneset nuk trajtohen në mënyrë të barabartë dhe krijojnë konkurrencë të padrejtë

**Shkeljet në prokurimin publik rezultojnë nga mënyra se si formulohen specifikimet teknike. Në shumicën e rasteve ato përcaktojnë paraprakisht fituesin e tenderit në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit, i cili kërkon nga autoritetet kontraktuese që të hartojnë specifikime teknike në mënyrë që të sigurohet një qasje sa më e madhe e mundshme për të gjithë operatorët dhe ofertuesit e interesuar ekonomik dhe në të njëjtën kohë i ndalon autoritetet kontraktuese që të përpilojnë specifikime teknike që favorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë.**

Konstatohen shkelje në zgjedhjen e procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës”. Në disa raste kjo bëhet në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5, për arsye se autoritetet kontraktore kanë ndryshuar kushtet e kontratës nga një procedurë në tjetrën. Kjo procedure duhet të zbatohet vetëm kur nuk ka asnjë ofertë, nuk ka oferta të përshtatshme, ose nuk është paraqitur asnjë kërkesë në përgjigje të procedurës së hapur ose të kufizuar, **me kusht që në kushtet fillestare të kontratës të mos bëhet asnjë ndryshim thelbësor.**

Në auditime të KLSH konstatohen shkelje në mënyrën e vlerësimit të ofertave në tender, të bazuara kryesisht në kriterin e çmimit më të ulët, pavarësisht faktit se Ligji i Prokurimit Publik parasheh edhe kriterin e ofertës më të ulët të vlerësuar.

Konstatohen çmime të dyshimta që nuk përputhen me çmimet e tregut, duke dëmtuar paranë publike.

**Nënvizojmë** se shkeljet në prokurimin publik, përmes favorizimit të operatorëve të caktuar ekonomikë, jo vetëm që paraqesin shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik, por ato gjithashtu çenojnë edhe Kushtetutën e vendit e cila i detyron institucionet që të sigurojnë një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut dhe lirinë e aktivitetit ekonomik, si dhe të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Rekomandojmë të gjitha institucioneve përkatëse që janë përgjegjëse për implementimin e ligjit në fjalë dhe organeve të prokurimit publik, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për shmangien e praktikave të tilla, të cilat vështirësojnë edhe më tej konkurrencën e lirë dhe mjedisin tashmë të vështirë për të bërë biznes në vend. Përmirësimi i sistemit të prokurimit publik do të ndihmonte po ashtu në masë të madhe edhe menaxhimin e financave publike, duke eliminuar mundësitë e shpërdorimit të parasë së taksapaguesve.

**Burimi:** [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al) dhe [minfin.gov.al](http://minfin.gov.al)

---

<sup>i</sup> Botuar në gazetën “Ekonomia” datë 31 korrik 2013.

<sup>ii</sup> Ky shkrim botohet me disa shkurtime.

<sup>iii</sup> Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Auditimi i prokurimeve në entitetet publike (Ekonomia 27 korrik 2013)
- Auditimi i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore në entitetet publike (“55” 9 dhjetor 2013)
- Çështje të auditimit financiar dhe elementet e kontrollit të brendshëm (“55” 19 dhjetor 2013)
- “Auditimi financiar dhe elementët e kontrollit të brendshëm (Ekonomia 20 dhjetor 2013)